

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, dhe gjyqtarët profesionistë Shadije Gërguri dhe Violeta Namani anëtarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtor profesional Driton Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit T.G.për shkak të veprës penale të ricilësuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.873-2/09, të dt.31.01.2013, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, në të cilat kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ilaz Beqiri, i akuzuari T.G.dhe mbrojtësi i tij av.B.T., me dt.13.09.2018, mori dhe të njëjtën ditë, shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari T.G., i biri i H. dhe S.1, e gjinisë S.2, i lindur më ..., në P., ku edhe jeton, rr.R.A.’’, nr...., i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, kundër tij nuk zhvillohet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR**Sepse:**

Me dt.11.10.2009 rreth orës 15:50 minuta, në rr.’’Gj.S.’’, në P., derisa i dëmtuari D.K. ka qenë para shtëpisë së vet, duke e rregulluar veturën e tij, ka ardh i pandehuri me një veturë ‘’Reno Clio’’ në të cilën kanë qenë edhe dy persona të tjerë, prej të cilëve njeri e ka drejtuar veturën, ndërsa tjetri ka qenë i ulur në karrigen e pasme, i pandehuri i cili ka qenë ulur në ulësen e parë, afër shoferit, fillimisht e ka thirr të dëmtuarin ‘’o K.’’ dhe në momentin kur i dëmtuari përgjigjet me ‘’Hou’’, duke menduar se është ndonjë shokë i tij, pasi që e ka kthyer kokën se kush e thirri, në atë moment e ka vërejtur të pandehurin me revole në dorë, i cili nga dritarja e automjetit me xham të hapur, ka shtënë në drejtim të tij, fillimisht dy herë me rafalë, ndërsa pas disa sekondave edhe njëherë, përsëri në drejtim të tij merevole të tipit ‘’Cërvena Zastava’’ M-88A me nr.serik 20224 në kornizë dhe 3531 në tytë, gjysmë automatike, prodhim jugosllav të kalibrit 9x9mm, nga distanca 20-30 m e pastaj ka ikur nga vendi i ngjarjes me veturën me të cilën e dhe ka ardh, në drejtim të rr.’’Ismet Krasniqi’’, ndërsa i dëmtuari me lëvizjet e tij në anën e kundërt të të shtënave ka shpëtuar pa u goditur.

-me këtë ka kryer vepër penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së

Prandaj, gjykata konform dispozitave 2, 3, 42, 43 lidhur me 38, 64, 73,dhe328 par.1dhe 5 të KPK-së, si dhe nenit 359, 365, 366, 368, 450, 453 dhe 461 të KPPRK-së, e:

GJYKON

ME DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 2 (dy) vite, i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, e në rast të revokimit të dënimit me kusht, në dënimin e shqiptuar me burgim do ti llogaritet edhe koha e

kaluar në paraburgim prej dt.11.10.2009 deri me dt.20.11.2009, dhe prej dt.20.11.2009 deri me dt.20.12.2009 në arrest shtëpiak.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet pistoleta e tipit "Červena Zastava" M-88A, me një karikator 3 fishekë të kalib.9x19mm me nr.serik 20224 në kornizë, përkatësisht nr.3531 –në tytëe prodhimit jugosllav. Arma e konfiskuar duhet të shkatërohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari D.K. ka hequr dorë nga paraqitja e kërkesës pasurore-juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP.nr.873-2/09, të dt.31.01.2013, kundër të akuzuarit T.G., për shkak të veprave penale Vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 par.1 të KPK dhe Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.13.09.2018, dhe pas administrimit të provave materiale prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt.13.09.2018 ka bërë ricilësimin e veprimeve inkriminuese të të akuzuarit, duke mbetur përshkrimi i njëjtë i veprimeve inkriminuese të të njëjtit, ashtu që tani të njëjtin e ka akuzuar për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së dhe pas ricilësimit të këtyre veprave penale në një vepër penale, pra nga neni 328 par.1 të KPK-së i akuzuari T.G., ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së.

Meqë i akuzuari tani pas ricilësimit të veprës penale, e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale të ricilësuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranimin i cili është bërë vullnetarisht, pranimin i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pakontestuar të fakteve, gjykata vërtetoj se në veprimet e të akuzuarit T.G., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, ashtu që të akuzuarine dhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me vetë faktin se i akuzuari e pranoi fajësinë dhe se një pranimin i tillë i fajësisë është në përputhshmëri me të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, i propozon gjykatës që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit t'i vlerësojë si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë si dhe kohën e kaluar nga kryerja e

kësaj veprë penale, pra kanë kaluar afër 10 vite, dhe i propozon gjykatës që të njejtin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit T.G. av.B.T. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe rrethanat lehtësuese të propozuara nga prokurori që ti vlerësoj gjykata me rastin e shqiptimit të sanksionit penal, ashtu që të njejtin t'ia shqiptoj një dënim sa më të butë të mundshëm.

I akuzuari T.G.e mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe e lut gjykatën që duke pas për bazë të gjitha rrethanat t'ia shqiptoj një dënim më të butë të mundshëm.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 64 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin, vlerësoi faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë, sjelljen dhe qëndrimin e tij shumë korrekt në gjykatë, se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë, pendimi i thellë i tij për këtë veprë penale, premtimi i të njëjtin se në të ardhmen nuk do të përsërisë asnjëherë këto veprime, të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 42 të KPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike është marr konform nenit 461 par.1 të KPRK-së, pasi që i dëmtuari D.K. gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ka hequr dorë nga paraqitja e kërkesës pasurore juridike.

Vendimi lidhur me konfiskimin e pistoletës të tipit "Cërvenazastava" M-88A, e kalib.9x9mm me nr.serik 20220 në kornizë, përkatësisht nr.3531 –në tytë është marrë konform nenit 328 par.5 të KPK-së, si mjet ky me të cilën është kryer vepra penale.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.24/13, të dt.13.09.2018

Bashkëpunëtori profesional
Driton Berisha

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari
Beqir Kalludra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesanë afat prej 15 ditësh, prej ditës së marrjes së të njëjtin, Gjykatës Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.